

# Diplomë austriake e gjuhës gjermane (ÖSD)

## Rregullorja e provimit

Versioni: Maj 2020



## Përmbajtja

ÖSD-RREGULLORJA E PROVIMIT.....	3
1. Bazat.....	3
2. Pranimi në provimin ÖSD.....	3
3. ÖSD-Qendrat e provimeve, ÖSD-Ekzaminerët.....	4
4. Terminet e provimeve, regjistrimi për provim.....	5
5. Pagesa për provim dhe kthimi i pagesës .....	5
6. Materialet e provimit, konfidencialiteti.....	6
7. Verifikimi i identitetit.....	6
8. Zhvillimi i provimit, mbikqyrja.....	7
9. Tërheqja nga provimi ÖSD ose ndërprerja i provimit ÖSD.....	7
10. Përrjashtimi nga provimi ÖSD.....	7
11. Vlerësimi.....	8
12. Njoftimi për rezultatet e provimit ose certifikatave të ÖSD .....	9
13. Përsëritja e provimit ÖSD .....	10
14. E drejta për të parë provimin dhe për ankesë.....	10
15. Siguria e cilësisë .....	11
16. Dokumentimi, arkivimi .....	11
17. Mbrojtja e të dhënave.....	11
18. Dispozitat përfundimtare.....	11

## ÖSD-RREGULLORJA E PROVIMEVE

Provimet e ÖSD shërbejnë si dëshmi (për të demonstruar) zotësi në gjuhën gjermane në nivelin përkatës sipas Kornizës së Përbashkët Evropiane të Referencës për Gjuhë (GER) dhe mbahën në qendrat e licensuara nga ÖSD anembanë botës dhe në përputhje me rregullat e përgjithshme.

### 1. Baza

Rregullat aktuale të provimit zbatohen për provimet ÖSD të listuara në pikën 2, ku zbatohet versioni i vlefshëm në kohën e aplikimit.

Provimet ÖSD përbëhen nga katër nënteste *lexim, dëgjim, shkrim dhe me gojë*. ÖSD ofron provimet për *certifikatën ÖSD B1* për të rriturit dhe për adoleshentët si dhe *certifikatën ÖSD C2* në katër module. D.mth. nëntestet/modulet *lexim, dëgjim, shkrim dhe me gojë* mund të paraqiten individualisht ose në ndonjë kombinim. Të gjitha provimet e tjera ÖSD ofrohen në dy module: Provimi me shkrim (*leximi, dëgjimi, shkrimi*) dhe *provimi me gojë*. Modulet përkatëse më poshtë quhen edhe provime.

Në [www.osd.at](http://www.osd.at) ju mund të shkarkoni një test model (= Modellsatz) pa pagesë për çdo provim. Rregullat e zbatimit, të cilat gjithashtu janë në dispozicion në internet, përmbajnë detaje mbi përmbajtjen, strukturën, kohëzgjatjen, procedurën dhe vlerësimin e provimit përkatës dhe janë ligjërisht të detyrueshme në versionin e tyre aktual.

Për përgatitje të provimit shërbejnë edhe *materialet shitesë për ushtrime*, të cilat mund të porositen në internet.

### 2. Pranimi për provimin ÖSD

Në parim është e mundur që të gjithë të interesuarit të marrin pjesë në provimin e ÖSD-së. Përjashtimet vlejné për ata persona që janë të përjashtuar nga provimi për arsyet e përmendura në pikën 10 dhe që nuk kanë të drejtë për provim deri në skadimin e periudhave të bllokimit të rregulluara në pikën 10.

Personat që kanë falsifikuar certifikatat ÖSD ose paraqesin një certifikatë të falsifikuar përjashtohen nga pjesëmarrja në provime në të gjitha qendrat e provimeve ÖSD në mbarë botën për një vit që nga data e zbulimit të falsifikimit në qendrën ÖSD. Qendra e ÖSD-së rezervon të drejtën për t'i përjashtuar përgjithmonë këta persona nga provimet edhe në të ardhmën (shih pikën 10).

Personat që nuk kanë kaluar provimin ose një modul, përjashtohen nga pjesëmarrja në provim deri në afatet e përcaktuara nga qendra përkatëse e provimeve për përsëritjen e provimit (shih pikën 13).

Nuk është e nevojshme për të kaluar një provim në një nivel më të ulët ose për të përfunduar një kurs gjerman ose kurs përgatitor për të marrë pjesë në provimin e ÖSD-së. Secili modul i provimit mund të merret në mënyrë të pavarur nga kalimi i moduleve të tjera.

Për provimet individuale ÖSD, rekomandohen moshat në vijim:

<b>Nga mosha 10 vjeçare</b>	<b>Nga mosha 12 vjeçare</b>
<p>ÖSD KID A1 ÖSD KID A2</p>	<p>ÖSD Certifikatë gjermanisht Austri B1 / Të rinjë ÖSD Certifikatë B1 / Të rinjë</p>
<b>Nga mosha 14 vjeçare</b>	<b>Nga mosha 16 vjeçare</b>
<p>ÖSD Certifikatë A1 ÖSD Certifikatë A2 ÖSD Certifikatë B2 / Të rinjë ÖSD Certifikatë C1 / Të rinjë</p>	<p>ÖSD Certifikatë gjermanisht Austri B1 ÖSD Certifikatë B1 ÖSD Certifikatë B2 ÖSD Certifikatë C1 ÖSD Certifikatë C2 ÖSD Certifikatë C2 / Gjermanishtja për biznes</p>

Kandidatët që zgjedhin të hynë në provim në kundërshtim me këto rekomandime duhet të jenë të vetëdijshëm që temat dhe kompleksiteti i detyrave mund të mos korrespondojnë me moshën e tyre. Një ankesë mbi rezultatin e provimit për këto arsye nuk është e mundur.

### **3. ÖSD-Qendrat e provimeve, ÖSD-Ekzaminerët**

Në provimet ÖSD mund të merret pjesë vetëm në qendrat e licensuara për provimet ÖSD. Qendrat e provimeve zgjidhen sipas kriterëve strikte dhe janë të obliguara me Marrëveshje të licensimit për t'iu përmbajtur standardeve të përcaktuara për cilësinë. Informata rreth qendrave të provimeve gjeni në [www.osd.at](http://www.osd.at).

Çdo qendër e provimeve emëron një person dhe zëvendësin e tij, të cilët janë përgjegjës për ecurinë dhe vlerësimin e duhur të provimeve ÖSD. Çdo provim mund të pranohet dhe vlerësohet vetëm nga ekzaminerët e certifikuar me një certifikatë të vlefshme për ekzaminere.

Në provimin me gojë, të paktën njëri nga dy ekzaminerët nuk mund të ketë një kandidat nga kursi i fundit i t/saj si pjesëmarrës në provim. Për përjashtime kërkohet miratimi nga qendra ÖSD. Kryesuesi i provimit dhe ekzaminerët duhet të heshtin lidhur me procesin dhe rezultatet e provimeve ndaj personave të tretë.

### **4. Terminet e provimeve, regjistrimi për provimin ÖSD**

Regjistrimi për pranim bëhet në qendrën përkatëse të provimeve ÖSD. Aty zbatohen modalitetet e regjistrimit dhe kushtet e qendrës së provimeve. Në [www.osd.at](http://www.osd.at) janë të disponueshme të gjitha qendrat e provimeve, si dhe informacionet për datat e provimeve.

Para regjistrimit për provim, personat e interesuar, në qendrën e provimeve të zgjedhur do të informohen në detaje rreth kushteve të kontratës, kërkesave të provimit, rregullave të ekzaminimit, rregulloreve të zbatimit dhe shpalljes së rezultateve të provimit. Rregullorja e ekzaminimit dhe rregulloret e zbatimit janë gjithashtu në dispozicion në faqen e internetit të ÖSD në versionin e tyre aktual. Duke u regjistruar për provim, kandidatët vërtetojnë (në rastin e të miturve kujdestarët ose përfaqësuesit ligjorë) se kanë marrë parasysh dhe pranojnë kushtet e kontratës, rregulloret ekzistuese për ekzaminim të ÖSD-së.

Qendra e provimit vendos për pranimin në provim sipas vendeve të lira në dispozicion.

E drejta ligjore për të hyrë në provim është efektive, vetëm pas pranimit nga qendra e provimit si dhe pagesës së plotë për provim.

Nëse është rast i përsëritjës së provimit dhe nuk është paraqitja e parë në provim, duhet të tregohet gjatë regjistrimit për provim.

Kandidatët me kufizime dhe/ose nevoja të veçanta janë të detyruar ta informojnë qendrën e provimit ose qendrën e ÖSD-së për këtë gjatë regjistrimit dhe të paraqesin një certifikatë përkatëse. Qendra e provimit dhe qendra e ÖSD-së trajtojnë informacionin e dhënë në mënyrë konfidenciale (në përputhje me Rregullorën mbi mbrojtjen e të dhënave).

Në konsultim me qendrën e ÖSD-së, mund të jepen kushtet e provimit të përshtatura për situatën individuale. Nëse për shkak të kufizimeve ose nevojave të veçanta nëntestet individuale nuk mund të mbahen, kjo do të shënohet në certifikatën pa treguar ndonjë arsye.

Informacione të mëtejshme lidhur me këtë mund të gjeni në „Fletëinformacionin: Kandidatët me nevoja të veçanta. ”

## **5. Tarifat e provimit si dhe kthimi i tyre**

Tarifat e provimit përcaktohen nga qendra e provimeve dhe duhet të paguhen nga pjesëmarrësit në provim brenda afatit të caktuar. Mundësia e kthimit të pagesës në rast të tërheqjes nga provimi ose ndërprerja e provimit (shih pikën 9) rregullohet nga qendra përkatëse për provime sipas kushteve të qendrës për anulim. Pjesëmarrësit të cilët janë të përjashtuar nga provimi (shih pikën 10) nuk kanë të drejtë për kthim të pagesës së provimit.

## 6. Materialiet e provimit, konfidencialiteti

Qendra e ÖSD-së do ti ofrojë qendrës së provimeve të gjitha materialet e provimit që kërkohen për mbajtjen e provimit. Materialet janë pronë e ÖSD-së. Ato janë të mbrojtura me të drejtën e autorit dhe nuk mund të ndryshohen ose kopjohen në asnjë formë. Të gjitha dokumentet e provimit janë konfidenciale dhe mbahen të mbyllura. Çdo përdorim jashtë datës së provimit të raportuar ose transferim tek një palë e tretë konsiderohet si keqpërdorim. Për çdo keqpërdorim duhet të njoftohet menjëherë qendra e ÖSD-së.

Një pjesëmarrje aktive në keqpërdorim ndjekët nga ÖSD sipas ligjit.

## 7. Verifikimi i identitetit

Qendra e provimeve është e detyruar të verifikoj pa dyshim identitetin e kandidatëve për provim para fillimit të provimit dhe të kontrolloj atë me anë të një dokumenti identifikues valid dhe me fotografi zyrtare (pasaportë, letërnjoftim, etj.) Mbikëqyrësit ose ekzaminuesit kontrollojnë të dhënat e shënuara në fletëvlerësimin e përgjithshëm para shpërndarjes së fletëve të punës dhe krahasojnë këto me të dhënat në dokumentin identifikues. Kandidatëve u kërkohet të mbajnë në dispozicion dokumentin identifikues së tyre gjatë gjithë procesit të ekzaminimit të provimit dhe ta paraqesin atë sipas kërkesës. Pa një dokument identifikues të vlefshëm dhe me fotografi, pjesëmarrja në provim nuk është e mundur. Qendra e provimit ka të drejtë, në konsultim me qendrën të ÖSD-së, të ndër marrë masa të mëtejshme për të sqaruar identitetin ose përcaktuar se cilat prova të identitetit duhet të paraqiten. Kandidatët konfirmojnë saktësinë e të dhënave të tyre dhe pajtimin me Rregulloren e Provimit me nënshkrimin e tyre. Një kopje e dokumentit identifikues do të futet në formularin e përgjithshëm dhe do të kthehet në qendrën e ÖSD-së së bashku me dokumentet e provimit.

Nëse ka ndonjë dyshim në lidhje me identitetin e pjesëmarrësve, fillimisht do të kërkohet të paraqesin një tjetër dokument identifikues. Nëse përforcohet dyshimi se kandidati/kandidatja nuk është identik/e me personin e caktuar, ai/a jo nuk do të lejohet të merr pjesë në provim. Në rast dyshimi - nëse dyshimet nuk mund të eliminohen tërësisht ose në mënyrë adekuate, - pjesëmarrja në provim është e mundur nëse kandidati/kandidatja pajtohet të fotografohet për qëllime të verifikimit të identitetit.

Deklarata duhet të jetë me shkrim dhe të ketë informacionet personale të mëposhtme: emri, mbiemri, data e lindjes, vendi i lindjes, shteti i lindjes dhe nacionaliteti. Kandidati/kandidatja duhet të sigurojë vetë informacionin personal dhe duhet të nënshkruajë deklaratën. Fotografia, një kopje e deklaratës dhe dokumenti identifikues dhe një deklaratë me shkrim për shfaqjen e dyshimeve të identitetit duhet të dërgohen menjëherë pas ekzaminimit në qendrën e ÖSD-së. Çertifikata do të lëshohet vetëm pas sçarimit të sigurt të identitetit.

Në rast tentim mashtrimi mbi identitetin, ÖSD rezervon të drejtën ligjore të ndërmerr hapat e nevojshëm.

## 8. Zhvillimi i provimit, mbikëqyrja

Provimet ÖSD nuk janë publike. Vetëm bashkëpunëtorë të autorizuar të qendrës së provimeve ose të qendrës ÖSD lejohen të jenë të pranishëm në provim.

Ecuria e duhur e provimit sigurohet përmes ekzaminerëve të licensuar dhe personave mbikëqyrës. Të paktën një mbikëqyrës i kualifikuar duhet ta mbikëqyr procesin e provimit për 15 kandidatë, jep informacionin e nevojshëm organizativ dhe është në dispozicion për pyetje lidhur me zhvillimin e provimit. Nuk lejohet të përgjigjen ose të komentohen pyetjet rreth përmbajtjes së provimit. Nëse është e paraparë me rregulloret e zbatimit që të shpjegohen detyrat, ose nëse duhet të përgjigjet në pyetje të mundshme, kjo duhet të bëhet vetëm në gjuhën gjermane.

Ecuria e provimit dokumentohet në protokolin e provimeve. Aty, ndër të tjera, duhet të shënohet qendra e provimit/vendi i provimit, termini i provimit (duke përfshirë orën), mbikëqyrësi/mbikëqyrësit, si dhe kandidati/kandidatja për provim si dhe të evidentohet çdo incident gjatë provimit.

Gjatë provimit me shkrim, kandidatët mund të largohen vetëm individualisht nga dhoma e provimit. Kjo do të shënohet në protokolin e provimit me emrin dhe orën. Nuk lejohet që të merret asnjë dokument i provimit nga dhoma e provimit.

Nëse kandidatët dëshirojnë të përfundojnë provimin para përfundimit të kohës së caktuar, ata duhet që t'i dorëzojnë të gjitha dokumentet e provimit. Pas largimit nga dhoma e provimit, ata mund të hyjnë prapë vetëm pas përfundimit zyrtar të provimit. Nuk lejohet që dokumentet e dorëzuara t'i jipen prap kandidatëve në provim.

## 9. Tërheqja nga provimi ÖSD ose ndërprerja e provimit ÖSD

E drejta ligjore për tërheqje: Tërheqja nga provimi është e mundur, por nuk ka të drejtë për kthim të pagesës së provimit. Nëse tërheqja ndodhë para fillimit të provimit, provimi konsiderohet i mbajtur. Nëse tërheqja ndodh pas fillimit të provimit, provimi konsiderohet jo i kaluar.

Në rast të tërheqjes nga provimi ose rast ndërprerje si dhe për arsye shëndetësore, duhet të paraqitet menjëherë një vërtetim nga mjeku. Qendra e provimit vendos për veprimet e mëtejshme dhe kthimin e pagesës së provimit (shih pikën 5).

## 10. Përjashtimi nga provimi ÖSD

Nga provimi përjashtohen personat që mashtrojnë në lidhje me mbajtjen e provimit ose tentojnë të mashtrojnë, pengojnë të tjerët gjatë provimit, ose sjellin ose përdorin ndihma të tjera të palejuara, përkatësisht ju ofrojnë ndihmë të tjerëve. Si ndihma të palejuara konsiderohen të gjitha materialet specifike, që nuk janë pjesë e dokumenteve të provimit ose që nuk janë parashikuar nga rregulloret e zbatimit (p.sh. fjalorët - varësisht nga provimi, materiale gramatikore, shënime etj.).

Pajisje teknike, si telefonat mobil, minikomputerat ose pajisje të tjera të regjistrimit, transmetimi  
Rregullorja e provimit | Versioni: Maj 2020 | © ÖSD



ose shpërndarja, nuk lejohet të merren në dhomën e përgatitjes ose në dhomën e provimit. Kandidatët mund të dorëzojnë çdo ndihmë/pajisje, sidomos telefonat celularë, të sjellura pa qëllime tjera, për kohëzgjatjen e provimit.

Ekzaminerët ose mbikëqyrësit kanë të drejtë të verifikojnë respektivisht t'i zbatojnë rregullat e mësipërme. Shkelësit e rregullave përjashtohen nga provimi. Edhe përpjekja për të ju dhënë çasje personave të tretë në përmbajtjet konfidenciale çon në përjashtim nga provimi. Në rast të përjashtimit, provimi nuk do të vlerësohen.

Kandidatët të cilët janë përjashtuar nga provimi për një nga arsyet e mësipërme mund ta përsëritin provimin më së shpejti pas tre muajve që nga data e përjashtimit nga provimi.

Në rast përjashtimi, pas vlerësimit të të gjitha rrethanave të rastit individual, personat e përfshirë në mashtrim të identitetit i nënshtrohen një periudhe përjashtimi njëvjeçare (shih pikën 2) në të gjitha qendrat e provimit ÖSD në mbarë botën.

Ky rregull zbatohet gjithashtu kur kandidati ofron, premtos ose ofron një personi të përfshirë direkt ose indirekt në provim, pagesa të paligjshme ose përfitime të tjera të paligjshme për dhënien e provimit dhe për të marrë certifikatën (klauzola kundër korrupsionit).

Nëse personat provojnë të mashtrojnë ose tentojnë të mashtrojnë lidhur me identitetin e tyre, atëherë përjashtohen nga provimi të gjithë personat e përfshirë.

Nëse një nga arsyet e përmendura në pikën 10 për një përjashtim nga provimi bëhet e njohur vetëm pas përfundimit të provimit, qendra ÖSD ka të drejtë të vlerësoj provimin si " jo i kaluar" dhe, nëse është e nevojshme, të kërkojë certifikatën e dhënë më parë dhe ta deklaroj atë të pavlefshme.

Në rastin e mashtrimeve të rënda ose mashtrimit të tentuar, qendra ÖSD rezervon të drejtën që përveç përjashtimit nga provimet e ardhshme sipas ndalesës të sipërpërmendur, edhe t'a ndaloj nga provimet e ardhshme.

## **11. Vlerësimi**

Dhënia e pikëve si dhe kufijtë për kalimin ose jo kalimin e provimit janë të përcaktuara me kriteret e vlerësimit nga ÖSD. Provimi kalohet nëse plotësohen kërkesat minimale (për provim / nëntest / modul).

Në rastin e plagjiarizmit, d.m.th. përdorimi i teksteve moster të gatshme, të mësuara paraprakisht, me të cilat është vështirë të dallohet një arritje e pavarur me shkrim ose me gojë, vlerësohet me zero pikë.

## 12. Njoftimi për rezultateve e provimeve ose certifikatave ÖSD

Zakonisht qendra në të cilën është mbajtur provimi, i interpreton kandidatëve rezultatin respektivisht certifikatat e ÖSD-së.

Nëse kandidati/kandidatja në provim ka marrë pjesë në provimin dhe e ka kaluar atë, ai/ajo merr një certifikatë (certifikatë për modul ose total). Në certifikatë, performancat e provimit dokumentohen në formë të pikave si dhe me nota ashtu siç rezultojnë nga shkalla e vlerësimit.

Nëse dy respektivisht katër modulet e provimit kalohen brenda një termini do të lëshohet një certifikatë e plotë që paraqet të gjitha modulet. Edhe kandidatët të cilët kanë kaluar modulet individualisht brenda një viti në qendër e marrin një certifikatë me të gjitha modulet, certifikata e përgjithshme. Në raste të veçanta, qendra e ÖSD-së mund të lëshojë një certifikatë të përgjithshme me të gjitha modulet me kërkesën e një kandidat me pagesë (shpenzimet e përpunimit dhe të transportit) edhe nëse modulet e kërkuara janë kaluar në qendra të ndryshme të provimeve brenda një viti.

Nëse janë kaluar modulet individuale, atëherë kandidatët marrin një certifikatë moduli – dëftesë për modul. Për provimet që nuk kalohen, nuk lëshohen certifikata.

Qendra e provimeve është e detyruar të ju dorëzojë kandidatëve certifikatat e provimit sa më shpejtë që të jetë e mundur në formë personale ose t'i dergoj ato me mjete të sigurta. Certifikatat që nuk tërheqen nga kandidatët do t'i kthehen qendrës së ÖSD-së pas gjashtë muajve (nga data e lëshimit të certifikatës).

Qendra e ÖSD-së rezervon të drejtën për të rivlerësuar një provim dhe për të lëshuar një certifikatë përkatëse në rast të devijimit të rezultateve. Certifikata e lëshuar kërkohet të kthehet dhe humb vlefshmërinë e saj.

Brenda një periudhe prej pesë vitësh, kandidatët kanë mundësinë të marrin një kopje duplikat të certifikatës së tyre të provimit. Për duplikate duhet të aplikohet në qendrën e provimeve ku është kaluar provimi, me paraqitjen e certifikatës origjinale ose me një dëshmi të humbjes së saj. Kandidatët mund të kërkojnë një duplikat direkt nga qendra e ÖSD-së vetëm në raste të jashtëzakonshme (p.sh. nëse qendra e provimeve nuk ekziston më ose është shumë larg). Krijimi i një duplikat është gjithmonë i lidhur me pagesë (përpunimi dhe shpenzimet e transportit).

Rishtypja e certifikatës origjinale bëhet nëse duhet të korrigjohet një gabim ose të bëhet një ndryshim dhe duhet dorëzuar certifikata origjinale. Kandidatët mund të aplikojnë për rishtypje direkt në ÖSD vetëm në raste të jashtëzakonshme.

Qendra ÖSD-së rezervon të drejtën për të shkuar përtej këtyre dispozitave dhe të bënë marrëveshje individuale me qendrat individuale ÖSD respektivisht të licensuarit nga ÖSD.

## 13. Përsëritja e provimit ÖSD

Është e mundur të paraqitet ose përsëritet një provim i tërë ose modulet sa herë që dëshironi. Moduli i provimit me shkrim mund të përsëritet vetëm si një i tërë, d.m.th. nëntestet lexim, dëgjim dhe shkrim nuk mund të paraqiten individualisht dhe të përfshihen në rezultat.

Në rast të mos kalimit, ÖSD rekomandon që provimi tjetër të merret pjesë në provimin e radhës më së afërmi katër javë pas provimit të mbajtur. Qendra e provimeve mund të caktojë afate lidhur me datën për përsëritje të provimit. Për këto informohen kandidatët gjatë njoftimit të rezultateve të provimeve. Nuk ekziston ndonjë e drejtë ligjore për një datë të veçantë të provimit (shih gjithashtu pikën 10).

## 14. E drejta për t'a parë provimin dhe për ankesë

Pjesëmarrësit e provimeve kanë të drejtë t'i shiqojnë detajet e vlerësimit të provimit të tyre, d.m.th. për të parë formularin përkatës të vlerësimit respektivisht formularin e përgjigjeve dhe vlerësimit dhe kanë të drejtë ankesë sa i përket vlerësimit. Në të dy rastet, vlenë një periudhë prej tre muajsh nga data e lëshimit të certifikatës.

Të miturit me zotësi të kufizuar të veprimit mund t'a shiqojnë provimin vetëm në shoqëri të përfaqësuesit ligjor dhe duhet të kenë pëlqimin e tyre për të paraqitur kërkesën.

Shiqimi bëhet në qendrën e provimeve në prani të kryesuesit të provimit, të zëvendësit të tij ose të një personi të besueshëm të caktuar nga ata. Nëse është e nevojshme, qendra e provimit do të kërkojë formularin e vlerësimit respektivisht formularin e përgjigjeve ose vlerësimit nga ÖSD. Dokumentet nuk mund t'i dorëzohen kandidatëve, si kopje apo si fotografi. Gjithashtu, shiqimi në dokumentet sekrete të provimit si të formularit të përgjithshëm nuk është i mundur.

Vlerësimi i provimit mund të kundërshtohet brenda afatit të përcaktuar (tre muaj nga data e lëshimit të certifikatës) në qendrën e provimeve brenda afatit të përcaktuar. Nëse është e nevojshme, një kundërshtim është gjithashtu i mundur direkt në qendër të ÖSD-së. Nëse ka arsye të mjaftueshme, një rivlerësim do të kryhet nga punonjësit në qendër të ÖSD-së. Arsyetimi i thjeshtë për një rezultat që nuk është arritur nuk është arsye për një vlerësim të ri.

Ankesa kundër ecurisë së provimit mund të bëhet vetëm menjëherë pas mbajtjes së provimit. Ankesa duhet të dorëzohet me shkrim tek udhëheqësit e qendrës së provimit ku është mbajtur provimi. Kryesuesi i provimit, pasi dëgjon të gjitha palët e përfshira, vendos për kundërshtim dhe harton një shënim mbi ecurinë. Në rast dyshimi, vendos qendra e ÖSD-së.

## 15. Siguria e cilësisë

Cilësia e vazhdueshme e provimit sigurohet nga kontrollat e rregullta të provimeve me shkrim dhe me gojë në kuadër të hospimitit dhe me inspektim në dokumentet e provimit nga stafi i OSD-së. Kandidatja/kandidati për provim pajtohet me këtë.

## 16. Dokumentimi, arkivimi

Për të dokumentuar arritjen me gojë, të gjitha provimet regjistrohen me zë. Regjistrimet si dhe dokumentet e provimit me shkrim ruhen të mbyllura në çelës deri në pesë vite dhe pas kesaj periudhe fshihen ose asgjësohen. Rezultatet e provimit të të gjithë kandidatëve në provim regjistrohen në mënyrë elektronike dhe arkivohen sipas nevojës.

## 17. Mbrojtja e të dhënave

Të gjithë personat e përfshirë në procesin e provimit janë të detyruar të ruajnë sekretin dhe të jenë në pajtim me politikat e zbatueshme për mbrojtjen e të dhënave. Zyra qendrore e OSD-së ka të drejtë të ruajë të dhënat personale dhe rezultatet e provimeve të kandidatëve në provim, t'i përpunojë ato në mënyrë elektronike dhe t'i dërgojë ato në zyrat përkatëse si komunat ose institucionet e ndryshme. Keto të dhëna qendra e OSD-së, me kërkesë të institucioneve të ndryshme, mund ti konfirmojë ose jo, në rast të dyshimit të justifikuar për falsifikim të certifikatës OSD-së. Të dhënat anonime mund të përdoren për qëllime vlerësimi.

## 18. Dispozita të veçanta në kohën e Covid-19

Për të parandaluar përhapjen e Covid-19 janë ato dispozita specifike të detyrueshëm për t'u zbatuar, të cilat janë të vlefshme në shtetin përkatës në të cilin qendra e provimit është rezident. Përgjegjësia për zbatimin e duhur sipas kërkesave ligjore dhe masat higjienike i përkasin qendrës së provimeve.

Për qendrat e provimeve OSD në Austri manuali i higjienës për Covid-19 nga Ministria Federale e Arsimit, Shkencës dhe Kërkimit përbënë udhëzues për masat që duhen ndjekur në përpikëri (manuali i higjienës për Covid-19 për institucionet arsimore të edukimit të të rriturve, manuali i higjienës për Covid-19 për universitetet dhe kolegjet, manuali i higjienës për Covid-19 për institucionet e arsimit bazik dhe shkollat).

Për qendrat e provimeve të OSD në mbarë botën respektivisht jashtë Austrisë vlejné urdhëresat e shtetit përkatës. OSD gjithashtu rekomandon respektim të përpikt të kërkesave të veçanta të masave higjienike dhe parandaluese (shiko udhëzimet OSD-COVID-19 dhe masat higjienike).

## 19. Dispozita përfundimtare

Këto rregullore të provimeve hyjnë në fuqi më 1 mars 2019 dhe vlejné për kandidatët për provim, të cilët hyjnë në provime pas 1 marsit 2019. Nëse rregullorja e provimit është e përkthyer, atëher në rast dyshimi vlenë versioni gjerman.

Përveç rregullores aktuale, vlejné udhëzimet e përcaktuara në rregullorën e zbatimit (shih [www.osd.at](http://www.osd.at)).